

TERMAT E REFERENCËS

Pozicioni: Finacier/e

Numri i kërkuar: 1(Një)

Tipi i Kontratë: Kontratë Shërbimi

Kontraktuesi: Organizata Përtej Barrierave

Kohëzgjatja: 20 Tetor 2018- 20 Dhjetor 2018

Afati i fundit i aplikimit: 15 Tetor 2018

RRETH ORGANIZATËS

Përtej Barrierave është një organizatë jo-qeveritare, jo-fitimprurëse e cila është themeluar në Qershor të vitit 2004 nga një grup te rinjsh me aftësi të kufizuar dhe të rinj të tjerë që sot janë pjesë e bordit drejtues të organizatës.

Misioni i organizatës është: të promovojë mundësi të barabarta për të gjithë të rinjtë dhe vecanerisht për të rinj me disavantazhe sociale duke u ofruar atyre mbështetje për tu fuqizuar dhe marrë pjese aktive në jetën e komunitetit. Qëllimi ynë kryesor është të integrojmë të rinjtë me probleme sociale dhe disavantazhe në shoqëri.

RRETH PROJEKTIT

Organizata Përtej Barrierave është implementuese e projektit “Shkëmbejmë Kulturat- Fshijmë Kufijtë” I cili financohet nga RYCO- Regional Youth Cooperation Office. Me pjesëmarrjen e 3 organizatave të tjera partnere ne rajonin e Ballkanit.

PEL, Maqedoni, Svetlost, Serbi, Blink, Kosovo

Projekti është I fokusuar kryesisht në shkëmbimin kulturor midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. **Objektivi I përgjithshëm I këtij projekti është rritja e kompetencave të të rinjve dhe punonjësve rinorë në katër vende të Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet mjeteve**



inovative arsimore në fushën e të mësuarit ndërkulturor, diversitetit kulturor dhe bashkëjetesës paqësore.

Qellimet specifike të këtij projekti janë:

- Të lehtësohet procesi i dialogut ndërkulturor të të rinjve nga 4 vendet e Ballkanit në fushën e të rinise duke përdorur qasje inovative dhe rritjen e cilësisë së punës së rinisë.
- Te nxise të rinjte avokojnë për dialogun ndërkulturor dhe diversitetin kulturor si një thesar dhe mbështetje të shoqërive tona dhe si një mjet për respekt të ndërsjellë, tolerancë dhe mirëkuptim.

Në këtë projekt janë parashikuar disa aktivitete:

- **Aktiviteti 1**, Kick off meeting implementuar nga organizata PEL, Maqedoni
- **Aktiviteti 2**, Trajnimi I Liderave te rinj implemetuar nga organizata Svetlost, Serbi
- **Aktivitetet 3, 4, 5 dhe 6** jane nen-aksione te cilat zhvillohen ne komunitetet lokale ne organizatat perkatese partnere ne Shkup, Prishtine, Sabac dhe Tirane me 30 pjesemarres nga secili partner (PEL, BBA, BLINK dhe Svetlost) gjate periudhes Shtator- Tetor 2018
- **Activiteti 7** Shkembim rinor I cili implementohet ne Durres, Shqiperi Pertej Barrierave
- **Activiteti 8** Eshte nje takim vleresues I projektit ne Prishtine, Kosove, nga datat I cili implemtetohet nga stafi I organizates BLINK.
- **Activiteti 9** Eshte nje fushate online qe do te implementohet nga te katert partneret (BBA, PEL, BLINK dhe Svetlost) nga Qershori 2018 deri ne Janar2019.

OBJKTIVAT E TOR

Lidhur me aktivitetin e raportimin Përtej Barrierave kërkon një ekspert projektsh për të raportuar në lidhje me aktivitete e projektit.

Qëllimi kryesor është që të raportohen në kohën e duhur dhe në menyrë të saktë të gjitha shpenzimet lidhur me këto aktivitete te implementuara nga partneret dhe BBA.

Ai/Ajo do të jetë përgjegjës për mbledhjen e dokumentave financiare, komunikimin me partneret dhe përpilimin e raportit te mesem financiar.



REZULTATET E PRITSHME TË KËTIJ AKTIVITETI:

1. Eksperti eshte personi përgjegjës që mbledh dhe perpiln raportin e mesem financiar per aktivitetet e implementuara nga partneret dhe Pertej Barrierave.
2. Përgjegjës për sigurimin e menaxhimit të shëndoshë të mjeteve monetare dhe disponueshmërinë e fondeve për zbatimin e aktiviteteve të projektit bazuar në planin e miratuar të punës dhe buxhetet.
3. Ofroni udhëzime dhe mbështetje për partneret dhe personelin e projektit në lidhje me financimin dhe sigurimin që të gjitha faturat dhe transaksionet janë në përputhje me rregullat.
4. Ndhmon në administrimin dhe kontrollin e fondeve

PROFILI I EKSPERTIT TË KËRKUAR

- Të jetë mbi 25 vjec
- Të ketë punuar më përpara me projekte rinore në fushën e edukimit jo-formal
- Të ketë mbaruar edukimin e larte, diploma ne ekonomi shikohet me perparesi.
- Njohje të gjuhës angleze dhe aftësi për të punuar në një ekip dhe në mënyrë të pavarur.

PËRGJEGJËSITË

- Të ketë bashkëpunim të ngushtë me koordinatorin dhe stafin e organizatës Pertej Barrierave dhe te jetë i/e hapur ndaj sugjerimeve
- Të ketë aftesi për të punuar në grup me partneret dhe stafin e BBA
- Përgatit timesheets për periudhën e kontraktimit, dhe t'ia dorëzojë kordinatorit.
- Përgatit raportin e kerkuar nga BBA Brenda dates 15 Dhjetor 2018.

MARRËVESHJA ME KONTRAKTUESIN:

1. Eksperti/a i/e përzgjedhur do të nënshkruajë një kontratë me organizatën kontraktuese Pertej Barrierave.

2. Pagesa e ekspertit do të kryhet sipas rregullave të aplikuara me kontratë shërbimi. Pagesa do të kryhet siç është parashikuar në kontratën e shërbimit të firmosur nga Kontraktuesi dhe i Kontraktuari.



PERIUDHA E KONTRAKTIMIT:

Periudha e kontraktimit është 2 muaj nga data 20 Tetor 2018 deri në 20 Dhjetor 2018.

Procedurat e aplikimit:

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin si më poshtë:

- Curriculum Vitae e rifreskuar me të dhënat e fundit
- Letër interesi
- Eksperienca të mëperparshme pune në këtë profil do te shikohen me prioritet.

Proçesi i përzgjedhjes:

Propozimet e marra do të vlerësohen sipas kriteve të mëposhtme:

- Propozimi për anen teknike (eksperienca, CV-ja) (70%)
- Çmimi (30%)

KU TË APLIKONI:

Dërgoni aplikimin tuaj me të gjithë dokumentat e kërkuara në një e-mail të vetëm në adresën: office@beyondbarriers.org deri më 15 Tetor 2018, ora 12:00 AM.

